

V E N D I M
Nr.493, datë 21.10.1999

**PËR NJË SHITESË NË BUXHETIN E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE
SPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8439, datë 29.12.1998 "Për buxhetin e shtetit të vitit 1999", me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 1999 i shtohet fondi prej 12 600 000 (dymbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për fushatën kulturore mbarëkombëtare "Lamtumirë mijëvjeçar".

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1999.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko